



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr. 251/5 Prot.

Tiranë, më 30.06.2016

**V E N D I M**

**Nr. 77, Datë 30.06.2016**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË  
MINISTRINË E SHËNDETESISË PËR PROJEKTIN  
“SHËNDETËSIA ELEKTRONIKE E SHQIPËRISË, REGJISTRI  
MBARËKOMBËTAR I SHËNDETËSISË ELEKTRONIKE”  
MBI ZBATIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE,  
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË, SI DHE VLERËSIMI  
I PROJEKTIT”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimi mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare për projektin “Shëndetësia elektronike e Shqipërisë, regjistri mbarëkombëtar i shëndetësisë elektronike” të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë, nga data e fillimit të projektit deri më datë 29.02.2016.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

### **1.Gjetje nga auditimi:**

-Projekti është konceptuar të ndahet në dy faza, faza e parë në shumën 7,483,000 euro dhe pjesa tjetër e huasë është për fazën e dytë. Projekti mbaron pas fazës së parë, nëse Procesi i Vlerësimit del me rezultat negativ. Procesi i vlerësimit bëhet nga Huadhënësi, në përfundim të fazës së parë. Nga auditimi u konstatua se në përfundim të fazës së parë maj 2015, vlerësimi është pozitiv dhe palët kanë rënë dakord që në shtator të vitit 2015 të fillojë faza e dytë. Në fazën e parë, projekti është implementuar në 8 pika shëndetësore dhe vlerësimi i Huadhënësit është datë 20.07.2015.

Në kontratën e blerjes parashikohen që në përfundimin e fazës së parë do të implementohej projekti në të gjitha site-t e qytetit të Tiranës dhe rrethinave. Në fakt konstatohet se në këtë fazë janë përfunduar 8 site, por vetëm dy janë në qytetin e Tiranës, Qendra shëndetësore nr. 2 dhe spitali gjeneologjik “Mbretëresha Gerardin”. Mos realizimi i objektivave për fazën e parë, është ndryshuar duke rënë dakord të dy palët që pjesa e mbetur për qytetin e Tiranës do të jetë angazhim për fazën e dytë.

-Nga mënyra se si është përcaktuar forma e disbursimit, rezulton se kredia është disbursuar në masën 93%, ndërsa instalimi i sistemit bëhet gradualisht, pra ndonëse shpenzimet për pajisjet dhe programet i janë disbursuar kompanisë ■■■■■ nuk ka përfunduar implementimi i projektit në të gjitha site-t. E shprehur ndryshe nga 79 site që do të pajisen me sistemin elektronik e-Health, 27 site janë përfunduar ose 36% e tyre.

-Për periudhën objekt auditimi u konstatua se sistemi e-Health është implementuar në 20 site, ku për 11 është lëshuar certifikata COHO, ndërsa për pjesën tjetër 9 site është implementuar sistemi i cili është vënë në funksion, ndonëse nuk janë lëshuar certifikatat COHO dhe kjo për mungesë të menaxherit të projektit nga MSH.

-Gjithashtu, rezulton se aktualisht projekti për procesin e certifikimit është stopuar për shkak të largimit të stafit ekzistues dhe mos zëvendësimit të tyre. Kështu në përbërjen e PIU-t mungon Udhëheqësi i Projektit, e cila ka qenë znj. ■■■■■ dhe Menaxheri i Projektit, z. ■■■■■. Nga ana e MSH ndonëse ka kaluar më shumë se dy muaj nuk janë zëvendësuar nga persona të tjerë.

Duke qenë para këtij fakti, në shtatë qendra është instaluar programi, trajnuar stafi përkatës si dhe vazhdon funksionimi i projektit, në një kohë që certifikata COHO nuk është lëshuar, pikërisht për arsye të mungesave në PIU. Në site-t ku është instaluar sistemi janë në funksion pra përdorin sistemin për hedhjen e të dhënave, ndonëse nuk janë lëshuar certifikatat e nevojshme, veprim ky në kundërshtim me pikën 1.3.1 të marrëveshjes së blerjes dhe me pikat 42-50 të seksionit “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Pas konstatimit të grupit të auditimit, për mungesën e stafit drejtues të PIU, Ministri i Shëndetësisë me urdhër nr. 164 datë 18.04.2016, ka zëvendësuar anëtarë e larguar nga Njësia e Zbatimit të Projektit.

### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Njësia e Zbatimit të Projektit të marri masa të menjëhershme, për certifikimin e instalimit të pajisjeve, për shtatë qendra shëndetësore, në të cilat është instaluar programi, trajnuar stafi përkatës si dhe vazhdon funksionimi i projektit, por për arsye të mungesës së stafit të PIU nuk është lëshuar certifikata COHO.*

***Menjëherë***

## **2.Gjetje nga auditimi:**

- Nga auditimi u konstatua se kontratës (marrëveshjes) së blerjes me objekt “Për regjistrin kombëtar elektronik të shëndetit në Shqipëri”, i janë bërë tre amendamente, të cilat janë miratuar nga palët. Me shkresën nr. 6112/2, datë 10.11.2014 të Ministrit, janë autorizuar znj. ■■■ dhe z. ■■■ për miratimin e ndryshimeve të mundshme që lindin nga zbatimi i kontratës me Nr. ALB2012, datë 5.01.2013 të projektit “Shëndetësia elektronike në Shqipëri - Regjistri Mbarëkombëtar i Shëndetësisë elektronike”, në përputhje me nenin 22, pika 3 të kësaj kontrate.

*Amendamenti parë* i kësaj kontrate është nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Drejtori Menaxhues i ■■■ në datën 02.06.2014 dhe është shtuar Aneksi N si pjesë integrale e kontratës, për të lehtësuar përlllogaritjet e kostove të mirëmbajtjeve post-kontraktuale dhe nuk do të ketë ndikim në faturat aktuale të kontratës.

*Amendamenti i dytë* është kërkuar në datën 17.12.2014 nga ana e ■■■ Arsyeja e këtij amendamenti ka lidhje me ndryshimet teknologjike të pajisjeve me kalimin e një kohe të konsiderueshme nga momenti kur janë bërë parashikimet e projektit. Pajisjet e mëparshme sipas shpjegimeve të dhëna ose kanë dalë jashtë përdorimit ose kanë parametra më të ulët në krahasim me pajisjet koherente. Këto ndryshime, siç edhe citohet në kërkesën e bërë, nuk kanë asnjë impakt në koston e projektit. Nga auditimi u konstatua se ky amendament është miratuar vetëm gjatë diskutimeve në mbledhjen e tretë të zhvilluar me përfaqësuesit e ■■■ dhe Ministrisë së Shëndetësisë në datën 06.03.2015, pa nënshkruar një “Contract Amendament” të posaçëm nga personat e autorizuar. Për këtë amendament është kërkuar konsultë edhe me Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, përgjigja e të cilit ka ardhur në datën 14.01.2015, ku shprehet se ndryshimet janë të karakterit teknik, si pasojë nuk mund të jepet një opinion.

*Amendamenti i tretë* i kërkuar në datën 25.02.2015 nga ana e ■■■ lidhet me ndryshimin e pajisjeve, si dhe numrit të tyre, në përputhje me ndryshimin e radhës së site-ve ku do të implementohet ky projekt. Edhe për këtë amendament është cituar se nuk do të ketë asnjë impakt në koston e projektit. Nga auditimi u konstatua se edhe ky amendament është miratuar vetëm gjatë diskutimeve në mbledhjen e tretë të zhvilluar me përfaqësuesit e ■■■ dhe Ministrisë së Shëndetësisë në datën 06.03.2015, pa nënshkruar një “Contract Amendament” të posaçëm nga personat e autorizuar.

*Amendamenti i katërt* i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë më datë 10.11.2015. Objekt i këtij amendamenti janë disa ndryshime në materialet e përcaktuara në kontratë. Krahas disa ndryshimeve të vogla të cilat lidhen me arkitekturën e site-ve, në amendament kërkohet ndryshimi i 270 lexuesve të kartave të identitetit me pajisje të tjera të papërcaktuara qartësisht, për arsye se këta lexues nuk do të përdoren, si pasojë e mungesës së kuadrit ligjor për shfrytëzimin e të dhënave demografike të popullsisë. Krahas pajisjeve të tjera që do të zëvendësojnë këta lexues do të jenë edhe 70 lexues bar-kodi. Ky amendament ende nuk është miratuar.

-Nga auditimi i projektit rezulton se në këto kushte, një ndryshim i tillë duket pak i sforcuar dhe i imponuar, duke pas si qëllim vetëm përmbushjen dhe përfitimin e vlerën të kontratës për shitësin ■■■ se sa për nevojat e projektit. Këtë fakt e dëshmon edhe arsyeja që ■■■ ka shprehur për shtesë të disa pajisjeve, meqenëse nuk do të sillen disa pajisje të tjera dhe jo për faktin se ndryshimi është i domosdoshëm dhe i nevojshëm në funksionimin e projektit.

Gjithashtu, theksojmë se shuma e kredisë prej 13,995,000 euro në këtë marrëveshje, konsiderohet si shumë maksimale, dhe jo si shumë e detyrueshme.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

Ministria e Shëndetësisë dhe [REDACTED] të marrin masa dhe të bëhet argumentim i plotë para se të nënshkruhet amendamenti i katërt i kontratës, kjo për arsye se ndryshimet e kërkuara nga kompania [REDACTED] nuk janë ndryshime të cilat janë në përmirësim të projektit, por kanë ardhur si pasojë e mospërdorimit të lexuesve të kartave të identitetit për projektin, si dhe qëllimi dhe objekti i kontratës së blerjes është implementimi i programit, jo realizimi i vlerës së kontratës, për më tepër hedhja e të dhënave bazike për projektin do të zgjidhet në një formë tjetër e cila do të sigurohet nga MSH dhe Zyra e Gjendjes Civile. Miratimi i një amendamenti për konvertimin e vlerës së lexuesve për kartat e identitetit me pajisje të tjera do të sjellë një rritje të pajustificuar të kostos së projektit.

**Menjëherë**

Duke ditur rëndësinë e ndryshimeve të kontratës, në vazhdimësi amendamentet të nënshkruhen nga personat përgjegjës në formate të veçanta (sipas amendamentit nr. 1) dhe jo të miratohen vetëm në Steering Committee, si pjesë e diskutimeve.

**Menjëherë**

### **3.Gjetje nga auditimi:**

-Në total për të tre vitet shuma e huasë (kredisë) së disbursuar është 13,001,695 euro ose në masën 92.9%. Për vitin 2014 është disbursuar shuma 6,571,250 euro ose në masën 46.9% e huasë, në vitin 2015 është disbursuar shuma 5,727,465.5 euro ose në masën 40.9% e huasë dhe në vitin 2016 shuma e disbursuar është 702,979 euro ose në masën 5%. Ka mbetur pa u disbursuar shuma 993,305 euro ose 7% e huasë.

-Shpenzimet dhe realizimet e Marrëveshjes së blerjes janë të njëjta me realizimin e disbursimit të kredisë, për arsye se shuma e kredisë është e njëjtë me shumën e Marrëveshjes (kontratës) së blerjes, pasi Projekti e-Health është projekt i cili ka një komponent “Sistemi dixhital që do të ruajë të dhënat e pacientëve në të gjithë vendin”. Për realizimin e komponentit është lidhur Marrëveshja e blerjes midis MSH dhe kompanisë [REDACTED] datë 05.01.2013, marrëveshje e cila është bërë efektive më datë 29.10.2014.

-Nga auditimi u konstatua se TVSH e paguar në total për projektin deri në mars 2016 është 175,830,648 lekë. Grupi i auditimit kërkoi që Drejtoria Ekonomike e MSH të nxjerrë këto të dhëna, pasi PIU në përbërjen e tij nuk ka një specialitet që të mbulojë anën financiare të projektit.

-Gjithashtu nga grupi i auditimit u kërkua që të merrej informacion në lidhje me të gjithë pagesat, tarifrat që janë kryer nga MF për kredisë e akorduar për projektin e-Health, pasi sipas marrëveshjes së kredisë detyrimet e kredisë përballohen nga MF. Me shkresën nr. 1220/2 datë 21.03.2016 nga MSH është kërkuar ky informacion dhe me shkresën nr. 4189/1 datë 7.04.2016 të MF është përcjell informacioni mbi pagesat në kuadër të projektit “e-Health, financim i UnitCredit Bank Austria”. Nga informacioni rezulton se deri në momentin e auditimit për këtë kredi janë paguar vetëm komisione në shumën gjithsej 220,818 euro me tetë pagesa, pagesat e principalit nuk kanë filluar ende dhe kredia është pa interes.

-Sipas kontratës së blerjes projekti duhet të përfundonte në qershor të vitit 2015, afat i cili nuk ka mundur të përmbushet dhe nga palët është rënë dakord që afati i përfundimit të projektit të jetë fundi i vitit 2016. Për periudhën e shtyrjes së afatit, pala shqiptare (MF) ka përballuar pagesat për tarifën e angazhimit, tarifë e cila paguhet për pjesën e pa tërhequr të kredisë. Në se projekti do ishte implementuar brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen e blerjes edhe disbursimi i kredisë do të ishte bërë brenda afatit, dhe si rrjedhojë nuk do të kishte lindur nevoja e pagesës së tarifës së angazhimit për periudhën pas qershorit të vitit 2015. Nga kjo periudhë deri në momentin e auditimit MF ka kryer

tre pagesa për tarifën e angazhimit në shumën gjithsej 49,254 euro, shumë e cila ka rritur koston e projektit, si pasojë e mos implementimit të tij brenda afatit, duke sjell efekt negativ .

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Ministria e Shëndetësisë dhe PIU i projektit e-Health të marrin masa që përfundimi i projektit të bëhet brenda afatit të ri të përcaktuar (fundi i dhjetorit 2016), me qëllim përmbushjen e objektit të Marrëveshjes, por edhe të reduktimit të pagesës për tarifën e angazhimit, tarifë e cila paguhet nga pala shqiptare (MF) për pjesën e pa tërhequr të kredisë, pasi për shtyrjen e afatit, tarifa e angazhimit e paguar më tepër është 49,254 euro, duke sjell rritje të koston së projektit.*

***Në vazhdimësi***

**4.Gjetje nga auditimi:**

-Me shkresën nr. 129, datë 02.02.2012 KM, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, i ka dërguar Ministrisë së Shëndetësisë studimin e miratuar nga Osterreichische Kontrollbank AG (OeKB), për projektin e-Health, studim i cili është bërë në zbatim të VKM nr.1081, datë 29.12.2010 për “Përzgjedhjen e kompanisë austriake që do të përgatisë studimin e fizibilitetit në lidhje me projektet në fushën e teknologjisë së informacionit që do të financohen në kuadër të bashkëpunimit financiar me Austrinë”. Me shkresën nr. 777, datë 23.02.2012 të MSH drejtuar MF është shprehur dakortësia për studimin e fizibilitetit dhe për koston e parashikuar në këtë studim në shumën rreth 15 milionë euro për projektin e-Health.

-Me VKM nr. 386, datë 27.06.2012 “Për procedurat për përzgjedhjen e eksportuesve austriakë që do të zbatojnë projektet në kuadër të bashkëpunimit financiar me Austrinë”, është përcaktuar se shoqëria austriake [REDAKTUAR] do të jetë koordinatori i projektit për organizimin e tenderit për përzgjedhjen e eksportuesve austriak që do të zbatojnë projektet në kuadër të marrëveshjes për financim datë 7 dhjetor 2010. Në pikën 2 të VKM nr. 386 është ngarkuar çdo ministri e linjës që për procedurat e tenderimit për përzgjedhjen e eksportuesit austriak që do të zbatojë projektin në fushën e tyre, të bashkëpunojë me [REDAKTUAR]

-Nga auditimi u konstatua se në MSH nuk është paraqitur nga koordinatori [REDAKTUAR] një raport përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së tenderimit të kryer në Austri për përzgjedhjen e shoqërisë e cila do të zbatojë projektin e-Health.

-Nga PIU i projektit na u paraqitën dy sete dokumentesh, njëri me dy volume të dokumenteve standarde të tenderit ku përfshihen dhe specifikimet teknike (volumi I udhëzime për ofertuesit dhe volum II ftesën për ofertë, të dhënat për ofertën dhe të dhënat për kontratën), set i cili nuk është shoqëruar me shkresë zyrtare nga koordinatori për zhvillimin e tenderit. Ndërsa seti tjetër është oferta ekonomike e shoqërisë [REDAKTUAR] e cila është edhe zbatuesja e projektit. Për të dy setet nuk ka një shkresë zyrtare se si i janë dorëzuar MSH dhe me çfarë praktike janë administruar nga Ministria.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*PIU e-Health të marri masa që të gjithë dokumentet e sjella nga pala austriake në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, të administrohen në një praktikë të vetme, duke krijuar një set të plotë dokumentesh, për dosjen e zhvillimit të tenderit, si dhe kjo praktikë duhet të arkivohet në përputhje me ligjin “Për arkivat”.*

***Menjëherë***

**5.Gjetje nga auditimi:**

-Në ofertën e paraqitur nga ofertuesi [REDAKTUAR] në dokumentet e tenderit në datë 23.08.2012, me të cilën është shpallur edhe fitues, konstatohet se kjo ofertë është e ndarë në zëra,

sipas elementëve përbërës të sistemit. Ndërkohë në Kontratën e Blerjes më datë 5.01.2013 të lidhur ndërmjet ■■■ dhe MSH konstatohet se kjo kontratë është lidhur për vlerën totale të ofertës, pa e ndarë atë në zëra sipas ofertës të paraqitur në tender dhe brenda çmimit të çdo pajisjeje apo programi është përfshirë edhe vlera e mirëmbajtjes, shërbimeve dhe trajnimeve duke i bërë të pa identifikueshme vlerat e zërave që janë përfshirë në ofertë.

-Në ofertën e paraqitur në tender zëri “Mirëmbajtje/Garanci” ishte parashikuar 1,800,000 euro ose 12.9% e vlerës totale të kontratës ndërsa në kontratën e lidhur ky zë nuk parashikohet me vlerë por do të sigurohet nga “Sigurimi i Detyrim Performancë” e cila është një llogari me 5% të çmimit total të kontratës, në datën e COHO-së së fundit të artikullit të fundit të pajisjes Detyrim i Performancës do të reduktohet pjesërisht me 50% të vlerës së tij, në mënyrë që vlera e mbetur e Detyrimit të Performancës të jetë atëherë 2.5% e totalit të çmimit total të kontratës. Shitësi ■■■ më datë 24.10.2014 ka paraqitur detyrimin e performancës në shumën 699,750 euro vlerë e cila është ngurtësuar te banka UniCredit Group Austria.

-Në lidhje me kontratën e blerjes u kërkuar të paraqitej sigurimi i kontratës së blerjes, ndërsa në fakt na u paraqit vetëm garancia për transportin e mallrave. Pra, rezulton se mungon sigurimi i kontratës së blerjes. Gjithashtu, në kontratë nuk është përcaktuar se si do të jetë forma e garancisë në përfundim të projektit. Nga mënyra se si është përcaktuar disbursimi, rezulton se në përfundim të projektit, me lëshimin e një certificate për performancën e projektit bëhet i gjithë disbursimi. Pra duke u gjendur para këtyre fakteve, rezulton se blerësi (MSH) është e pambrojtur nga mos përmbushja e të gjitha detyrimeve të kontratës së blerjes.

-Për realizimin e kontratës, ■■■ ka operuar me dy kompani, ■■■ e cila mbulon pjesën e kontratës që ka të bëjë me magazinimin e pajisjeve, transportin e tyre deri në site dhe instalimin e pajisjeve, programeve dhe testimin e tyre, dhe kompania ■■■ e cila mbulon pjesën e trajnimeve të stafit. Në kontratën e blerjes përcaktohet se e drejta dhe përgjegjësia e kontratës nuk mund të transferohet e gjitha apo në mënyrë të pjesshme pa pasur paraprakisht një marrëveshje me shkrim midis shitësit ■■■ dhe blerësit (MSH).

-Nga auditimi u konstatua se me dy kompanitë e sipërpërmendur, kompania ■■■ dhe MSH nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje për lejimin e transferimit të disa përgjegjësive për përmbushjen e kontratës. Për nën kontraktorin ■■■, kompania ■■■ ka sjell në MSH shkresën datë 9.03.2015 ose 5 muaj pas bërjes efektive të kontratës, ku njofton MSH se kjo shoqëri do të shërbejë si nën kontraktor vetëm për pjesën e magazinimit dhe transportit deri në site.

#### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Ministria e Shëndetësisë të marri masa që në të ardhmen, për kontratat që do të nënshkruaj me operatorët ekonomik, në kuadër të realizimit të projekteve dhe investimeve me financime të huaja (kredi/hua/grande), të përfshijë në kontratë të gjitha pikat e ofertës së shpallur fituese, pasi oferta fituese është pjesë integrale e kontratës, si dhe për të gjitha këto lloj kontratash të kërkojë nga operatorët ekonomik fitues, paraqitjen e sigurimit të kontratës, pasa nënshkrimit të kontratave përkatëse.*

***Në vazhdimësi***

#### **6.Gjetje nga auditimi:**

-Në zbatim të urdhrin të Ministrit nr. 149, datë 31.03.2015, është ngritur grupi i punës për verifikimin e pajisjeve hard-ware të projektit “e-Health në Shqipëri, Rekordet Elektronike Shëndetësore Mbarëkombëtare”. Nga auditimi i praktikave të mbërritjes së mallit në Shqipëri konstatohet se grupi i punës për verifikimin bashkë me përfaqësuesit e

kontraktorit kanë hartuar certifikatën COACS (Certifikatë e Mbërritjes të Magazinimit), certifikatë e cila dokumenton vetëm mbërritjen e mallrave në magazinë. Ky grup nuk ka bërë verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve të ardhura. Veprimet dhe mosveprimet e grupit të ngarkuar për verifikimin e pajisjeve janë në kundërshtim me pikat 42-50 të seksionit “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 1.3.1 e kontratës së blerjes.

-Nga auditimi i praktikave të transferimit dhe instalimit në site konstatohet se mallrat nuk janë marrë në dorëzim dhe kolauduar pajisjet dhe sistemi i instaluar, në çdo rast janë firmosur dy certifikatat, COHO (Certifikatë dorëzimi) dhe COI (Certifikatë instalimi), të dyja këto certifikata janë firmosur nga drejtori i qendrës shëndetësore/spitaleve, si përfaqësues i blerësit dhe nga përfaqësues i Ministrisë, në kundërshtim me Marrëveshjen (kontratën) e blerjes ku përcaktohet se në këto dokumente duhet që të konfirmohen dhe të firmosen nga pala e blerësit, që është Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu, firmosja dhe konfirmimi se sistemi është instaluar dhe funksionon në pajtim me kushtet e kontratës, nuk mund të bëhet nga përfaqësuesit e qendrave (site) ku është vendosur, pasi këta persona nuk kanë aftësitë profesionale për të garantuar cilësinë e sistemit elektronik.

-Nga auditimi i praktikave të trajnimeve konstatohet se urdhri i titullarit të qendrave shëndetësore ka dalë 2-3 ditë me vonesë, gjithashtu dokumenti që vërteton prezencën në trajnime (listë-prezenca) është hartuar në disa raste ditën e parë të trajnimit dhe nuk ka dokument tjetër që vërteton prezencën në ditët e tjera të trajnimeve.

-Nga auditimi i procesit të magazinimit të mallrave konstatohet se mallrat pas daljes nga dogana janë depozituar tek magazinat e kompanisë [REDAKTUAR] veprime këto në kundërshtim me kontratën e blerjes ku përcaktohet se Blerësi (MSH) duhet të sigurojë magazinimin e sigurt të mallrave të caktuar në përfitimin e lejes nga dogana për të gjitha pajisjet dhe artikujt e nevojshëm.

-Për çdo site para implentimit dhe instalimit të sistemit hartohet një raport mbi gjendjen aktuale të site-it dhe hartohet lista e produkteve që duhet për mirë funksionimin e sistemit në çdo qendër. Nga auditimi i disa praktikave u konstatua se midis produkteve të instaluar faktikisht dhe atyre të planifikuara ka ndryshime, por nuk ka asnjë dokumentacion që justifikon ndryshimet e ndodhura.

-Për funksionimin sa më të plotë projekti, ka nevojë për rregullim të kuadrit ligjor për kryerjen e mbrojtjes së të dhënave personale shëndetësore. Për këtë arsye, deri tani nuk është mundësuar shpërndarja e informacionit shëndetësor midis qendrave shëndetësore të përfshira në të. Nga auditimi u konstatua se MSH në zbatim edhe të marrëveshjes së huasë, nuk ka ndërmarr asnjë nisëm ligjor për plotësimin e kuadrit ligjor që duhet për zbatimin e këtij projekti.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Ministria e Shëndetësisë, PIU e-Health dhe Drejtoria Juridike të marrin masat e nevojshme për plotësimin e të gjithë kuadrit ligjor në lidhje me sigurimin e shkëmbimit të informacionit për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, për arsye se kuadri ligjor në fuqi ka mangësi, si dhe ky është një detyrim për palën shqiptare i sanksionuar edhe në Marrëveshjes e kredisë.*

***Menjëherë***

**7.Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi në terren u konstatua se ndërrimi i shpeshtë i stafit të trajnuar në qendrat shëndetësore ku projekti është instaluar dhe funksionon, ka krijuar vështirësi në ecurinë normale të tij. Gjithashtu, mos vënia në dispozicion nga qendrat shëndetësore të stafit të mjaftueshëm për funksionimin e projektit, si dhe kryerja e proceseve të projektit nga

personel i cili kryen edhe disa funksione të tjera njëkohësisht, ka sjell vështirësi dhe mosfunksionim të plotë të sistemit.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Ministria e Shëndetësisë si dhe qendrat shëndetësore (spitale/poliklinikat) në të cilat është implementuar programi e-Health dhe në ato që do të implemetohet, të marrin masa për të siguruar stafin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për funksionimin sa më të mirë dhe pa ndërprerje për projektin.*

***Menjëherë***

**8.Gjetje nga auditimi:**

-Nga drejtuesit e qendrave shëndetësore (site) dhe nga MSH, nuk janë marrë të gjitha masat e duhura për të bërë të mundur funksionimin e plotë dhe pa ndërprerje të hedhjes së të dhënave në regjistrin elektronik. Kështu në përgjithësi personeli mjekësor refuzon të plotësojë formularin “Përmbledhja e daljes”, duke qenë se fushat që përmban ky formular janë të njëjta me shënimet që mjeku përcakton në Kartelën Klinike dhe në Kartelën Ditore të pacientëve.

Nga drejtuesit e qendrave shëndetësore nuk është nxjerr një urdhër i brendshëm ku të përcaktohet detyrimi dhe përgjegjësitë që personeli mjekësor ka për zbatimin e projektit në përgjithësi dhe për plotësimin e formularit “Përmbledhja e daljes”. Kjo situatë për qendrat shëndetësore vështirësohet edhe më tepër për faktin që MSH nuk ka marrë asnjë masë për përfshirjen e formularëve që gjeneron sistemi i e-Health në listën e dokumenteve detyruese që duhet të plotësohen nga personeli mjekësor.

Theksojmë se këto mangësi në funksionimin e programit e-Health, grupi i auditimit i ka konstatuar për çdo qendër shëndetësore ku është implementuar projekti.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për të bërë të mundur përfshirjen e formularëve të e-Health në dokumente detyruese për tu plotësuar, pasi të dhënat që përmbajnë formularët e-Health janë të njëjta me të dhënat që mbahen nga qendrat shëndetësore, por i shërbejnë qëllimit të vetë projektit, i cili ka të bëjë me zëvendësimin e hedhjes së të dhënave në mënyrë manuale me atë elektronike. Gjithashtu, forma detyruese e plotësimit të formularëve e-Health do të bëjë të mundur regjistrimin e të gjithë pacientëve, pasi aktualisht në qendrat shëndetësore që është implementuar projekti, nuk bëhet regjistrimi i të gjithë pacientëve, shumica e regjistrimeve bëhen post-faktum, regjistrimi bëhet i pjesshëm d.m.th bëhet vetëm regjistrimi i të dhënave bazike të pacientit në recepsion duke e lënë procesin e punës të hapur dhe duke mos plotësuar asnjë të dhënë klinike. Faktikisht plotësimi dhe hedhja e të dhënave në sistemin e-Health është në vullnetin dhe përgjegjshmërinë personale të personelit të përcaktuar për mbulimin e funksionimit të projektit.*

***Menjëherë***

**9.Gjetje nga auditimi:**

-Në shumicën e qendrave spitalore ku është implementuar projekti nuk ka specialist IT i cili të monitorojë sistemin e-Health, por edhe në ato site ku ka specialist IT nuk kryhet një gjë e tillë (monitorimi i sistemit).

Projekti e-Health funksionon me dy nivele, i pari ka të bëjë me regjistrimin e të dhënave bazike në recepsion, ku bëhet dhe printim i formularit “Përmbledhja e vizitës së mjekut specialist/Përmbledhja e daljes”, formular të cilët plotësohen nga mjeku specialist (për



poliklinikat) dhe nga mjekët e reparteve (për spitalet). Mjekët përkatës plotësojnë me shkrim secilën fushë që përmbajnë formularët. Këta formularë dorëzohen nga mjeku te operatori i hedhjes së të dhënave (back office).

-Rezultoni se procesi i projektit e-Health nuk është i gjithi elektronik, si dhe nga mënyra e funksionimit mbart shumë gabime të mundshme dhe pasiguri, për vetë faktin që operatori i hedhjes së të dhënave nuk është pjesë e stafit mjekësor, për më tepër që ky person duhet të hedhë në sistem; mjekimin që përdor pacienti, amnezat (sëmundjet e mëparshme), ekzaminimin fizik, rezultatet e ekzaminimeve, diagnozat, mjekimin dhe planin e trajtimit, fusha të cilat plotësohen nga mjekët me shkrim dore.

-Gjithashtu, operatori nuk mund që të bëjë hedhjen e të gjithë të formularëve në kohë reale, pasi volumi i punës është i madh dhe në shumë raste hasin vështirësi në leximin e shënimeve të lëna me shkrim dore nga mjeku.

-Dosja elektronike e pacientit mund të modifikohet nga operatori në çdo moment, duke rritur shkallën e pasigurisë së projektit. Aktualisht projekti nuk gjeneron asnjë lloj raporti apo të dhëna statistikore, në lidhje me numrin e pacientëve, llojin e sëmundshmërisë, grup moshat etj. Sistemi nuk mund të bëjë share (transmetim informacioni) me qendrat e tjera ku është implementuar projekti. Ky problem është i njëjtë për të gjithë site-t ku është implementuar projekti i sistemit e-Health.

-Sipas marrëveshjes së blerjes, për hedhjen e të dhënave bazike në sistemin e-Health, sistemi do të mund të identifikoj dhe regjistroj nga Karta e Identitetit e pacientit. Nga auditimi u konstatua se projekti nuk ka mundur ta sigurojë një funksionim të tillë dhe kjo për arsye se të dhënat personale nuk janë vënë në dispozicion nga shoqëria ■■■ e cila është kontraktuar nga shteti shqiptar për emetimin e kartave të identitetit, për arsye se këtë shërbim, përdorimin e bazës së të dhënave kompania ■■■ e ofron kundrejt një pagese vjetore.

Ministria e Shëndetësisë e gjetur para këtij fakti ka kërkuar marrjen e të dhënave nga baza e të dhënave (data base) e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me të cilën është në negociim për përdorimin e të dhënave.

#### ***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Ministria e Shëndetësisë të marrë masa për të zgjidhur sa më shpejt pengesën e shkaktuar në hedhjen e të dhënave bazike nëpërmjet leximit të kartave të identitetit me bar code, pasi kjo situatë ka sjell vonesa në funksionimin e projektit dhe rrezikon mbarëvajtjen, si dhe 270 lexuesit e bar-kodit të parashikuara në kontratën e blerjes dalin të panevojshëm.*

***Menjëherë***

#### **10.Gjetje nga auditimi:**

- Nga auditimi në terren i site-ve: Poliklinika e Specialiteteve nr. 2, Spitali Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Spitali Rajonal Elbasan, Poliklinika e Specialiteteve Elbasan, Spitali Librazhd, Poliklinika e Specialiteteve Librazhd, Spitali dhe Poliklinika e Specialiteteve Lushnje, Spitali dhe Poliklinika e Specialiteteve Laç, u konstatuan mangësi në mënyrën e menaxhimit të procesit të instalimit të projektit dhe në menaxhimin e tij nga ana e punonjësve, më konkretisht:

Drejtorët e site-ve/qëndrave shëndetësore nuk kanë ngritur në kohën e duhur komisionin e marrjes në dorëzim të pajisjeve të projektit. Pajisjet janë bërë hyrje në magazinën e institucionit me vonesë veprim ky në kundërshtim me pikë 39 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Personi i ngarkuar në recepsion tek poliklinikat e specialiteteve për regjistrimin në sistem të pacientëve, nuk mund të regjistronte në kohë reale për shkak të fluksit të madh të

pacientëve, por i regjistronte dhe printonte formularin “Përmbledhje e vizitës” në një kohë të dytë, kjo situatë bën që të ketë shmangie nga numri real i vizitave.

Operatori i hedhjes së të dhënave nuk mund të bënte hedhjen e të gjithë formularëve në kohë reale, pasi volumi i punës është i madh. Për identifikimin e pacienteve të cilët paraqiten për rikontroll mjekësor, identifikimi i dosjes elektronike ekzistuese nga operatori, nuk mund të bëhet nga lexuesi i bar-kodit, sepse kjo pajisje nuk funksiononte ose në disa raste nuk ishte venë fare në punë, por kërkohej në mënyrë manuale nëpërmjet të dhënave bazike.

U konstatuan mangësi në printimin e formularëve nga sistemi në recepsion, plotësimin e tyre nga mjekët apo edhe në hedhjen e tyre në back-office.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Drejtorët e qendrave shëndetësore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të marrin masa konkrete për implementimin e plotë të sistemit duke regjistruar dhe hedhur të gjitha të dhënat klinike në sistem.*

*Drejtorët e qendrave shëndetësore të marrin masa për plotësimin me staf të dedikuar me kohë të plotë në postet e punës të parashikuara për projektin pasi kjo ka sjell vonesa dhe mos funksionim si duhet të projektit.*

*Drejtorët e qendrave shëndetësore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të marrin masa për hartimin e urdhrat të brendshëm ku të jenë përcaktuar personat përgjegjës dhe detyrat përkatëse për mirëfunksionimin e projektit si dhe plotësimin nga mjekët të formularëve të gjeneruar nga sistemi.*

***Menjëherë***

**11.Gjetje nga auditimi:**

- Nga krahasimi i të dhënave të hedhura në sistem u konstatua se në regjistrat e Poliklinikës nr. 2 Tiranë për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 69.040 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 3.677 pacientë ose 5.3% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 23.470 ndërsa në sistem janë hedhur 838 pacientë ose 3.6 % e vizitave.

Në regjistrat e Spitalit Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 11,380 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem nuk janë hedhur. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 3.901 ndërsa në sistem nuk janë hedhur.

Për periudhën shkurt-mars 2016 numri i pacientëve të regjistruar në regjistër në Poliklinikë është 4.046, ndërsa numri i pacientëve të hedhur në sistem është 144 ose 4.3%.

Në regjistrat e Poliklinikës Librazhd për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 12.628 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 4.323 pacientë ose 34% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 6.027 ndërsa në sistem janë hedhur 1.557 pacientë ose 26 % e vizitave.

Në regjistrat e Spitalit Elbasan për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 15.231 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 8.795 pacientë ose 58% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 4.299 ndërsa në sistem janë hedhur 2.764 pacientë ose 64% e vizitave.

Në regjistrat e Poliklinikës Elbasan për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 110.924 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në

sistem janë hedhur vetëm 4.256 pacientë ose 3.8% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 28.226 ndërsa në sistem janë hedhur 1.618 pacientë ose 5.7% e vizitave.

Për periudhën shkurt-mars 2016 numri i pacientëve të regjistruar në regjistër është 6.774, ndërsa numri i pacientëve të hedhur në sistem është 897 ose 15.6%.

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*Drejtorët e qendrave shëndetësore të marrin masa për rritjen e shkallës së hedhjeve të të dhënave në sistem si dhe të monitorojnë vazhdimisht ecurinë në kohë të projektit dhe shkallën e hedhjes së të dhënave mjekësore duke bërë prezent rëndësinë e tyre në realizimin e objektivit kryesor të projektit.*

***Menjëherë***

## **B. MASA ZHDËMTIMI**

### **1.Gjetje nga auditimi:**

-Me shkresën nr. 5086, datë 02.04.2015 MF ka përcjell në MSH dokumentet e dërguara nga pala austriake për pagesën e blerjes së pajisjeve hardware, fatura nr. 111520002, datë 13.03.2015 në shumën 1,246,244 euro ose 80% të totalit të vlerës së të gjithë pajisjeve, vlerë e cila është 1,557,806 euro. Me Memo datë 23.03.2015 PIU, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit Ekonomik të MSH, ka konfirmuar se pajisjet të cilat kanë mbërritur në doganën e Tiranës, janë pjesë e projektit e-Health dhe për këtë kanë kërkuar të procedohet me pagesën e TVSH sipas deklaratës së agjentit doganor. Me urdhër pagesën nr. 83, datë 25.03.2015 janë paguar TVSH për 29 pajisje të programit e-Health në shumën gjithsej 43,730,729 lekë. Me shkresën nr. 1690/1, datë 7.04.2015 ish-drejtori i projektit z. [REDAKTUAR] i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm dhe për dijeni Drejtorit Ekonomik të Ministrisë, ku u ka bërë me dije se dërgesa e pajisjeve të përcaktuara në dokumentin e emërtuar Attachment A-Equipment of 2<sup>nd</sup> Delivery (Hardware) është realizuar kundrejt kushteve të kontratës për këtë dërgesë, me përjashtim të artikullit me numër rendor 49, me product code OPSERA-OPSV dhe me çmim për njësi **113,200 euro**, produkt i cili nuk rezultoi prezent. Nga auditimi u konstatua se për këtë produkt MSH në momentin e paraqitjes së deklaratës doganore, ka shlyer detyrimin për TVSH.

- Me njoftimin e bërë nga drejtori i PIU për mungesën e këtij produkti, nuk është kryer asnjë veprim nga Drejtoria Ekonomike për të bërë rregullimin dhe korigjimin për pagesën e TVSH të paguar për një produkt i cili nuk ka mbërritur dhe që mungon. Gjithashtu, edhe PIU e-Health nuk ka asnjë praktikë ku të përcaktojë arsyet pse ky produkt mungon, në një kohë që nga shitësi është listuar në listën e produkteve të sjella me faturën nr. 111520002.

-Pas konstatimit të bërë nga grupi i auditimit dhe pas kërkesave për të sqaruar mungesën e produktit OPSERA-OPSV, nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit që është njëkohësisht dhe Drejtuese për IT dhe Infrastrukturën e PIU e-Health, grupit të auditimit iu paraqit një CD e thjeshtë e cila përmban një kopje të programit OPSERA-OPSV, program i cili është download (shkarkuar) nga blerësi AME nga adresa zyrtare e OPSVIEW. Këtë fakt e tregon edhe korrespondenca elektronike midis PIU/ [REDAKTUAR] dhe Projekt Menaxherit të kompanisë [REDAKTUAR]

-Me e-mail datë 21.04.2015 anëtarja e PIU-t i është drejtuar Projekt Menaxherit, ku i ka kërkuar shpjegime se si do të funksionojë programi OPSERA-OPSV, pasi në kontratë është parashikuar vetëm një program monitorimi i cili do të mbulojë të gjitha site-t dhe data center, dhe se nga testimi i bërë në AKSHI nga MSH, rezultoi se programi

OPSERA-OPSV ishte instaluar për data center. Me e-mail date 22.4.2015 Projekt Menaxheri austriak ka kthyer përgjigje që programi në fjalë është i instaluar dhe se është pa limit në përdorim, një instalim i ri nuk mund të bëhet duke qenë se shoqëria OPSVIEW e ka ndërprerë download nga faqja e saj zyrtare. Sistemi i instaluar është sistem i cili mund të monitoroj më shumë se 400 njësi në të njëjtën kohe. Me e-mail datë 22.04.2015, anëtarja e IT të PIU, ka kërkuar shpjegime përse sistemi i instaluar i OPSERA-OPSV është i vitit 2009 dhe jo version më i ri 2012-2015. Kompania [REDAKTUAR] ka kthyer përgjigje se sistemi i instaluar (OPSERA versioni 2009) ka qenë falas deri në datën 4 mars 2015.

Nga sa më lart rezulton se programi i instaluar OPSERA-OPSV është download (shkarkuar) nga faqja zyrtare e OPSVIEW, pra blerësi [REDAKTUAR] këtë program nuk e ka blerë, ndonëse sipas listës bashkëlidhur faturës nr. 111520002 çmimi i programit është faturuar në shumën 113,200 euro, gjithashtu ndonëse programi është free (pa pagesë) nga MSH janë paguar shpenzimet për TVSH duke e çuar vlerën e produktit në shumën **135,840 euro, shumë e cila përbën dëm ekonomik.**

***Për sa më lartë rekomandojmë:***

*Nga Ministria e Shëndetësisë dhe PIU e-Health të merren masa që shuma 135,840 euro, e cila është vlera e produktit OPSERA, ti zbritet nga pagesat që do të kryhen në vazhdimësi për kompaninë [REDAKTUAR] për arsye se versioni i programit të instaluar në momentin që është instaluar për projektin, ka qenë pa pagesë (free).*

***Menjëherë***

**2.Gjetje nga auditimi:**

- Nga auditimi u konstatua se për pagesat e shitësit kompanisë [REDAKTUAR] nuk janë bërë ndalesa e tatimit të të ardhurave. Kompania [REDAKTUAR] e cila ka kryer aktivitet në vendin tonë, e si e tillë është subjekt rezident dhe nuk është regjistruar në QKR. Nuk është regjistruar në organet tatimore, asnjë përfaqësues tatimor apo degë e shoqërisë. Nga PIU/MSH, për aktivitetin e kryer nga kjo kompani, nuk është kërkuar dhe nuk është bërë ndalesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituar nga kompania dhe të gjeruara në territorin e RSH, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar ku në nenin 5 pika 1 germa “ë” përcaktohet se “Tatim” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore. Për kontratën e blerjes nuk është mbajtur për çdo pagesë tatimi në burim, veprim ky në kundërshtim me nenet 4, germa “c”, 7 si dhe nenin 33, germa “d” e pika 2, të ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatëse, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tij, me nenet 6 pika 1, 8 pika 2 dhe 9 të ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

Gjithashtu, rezulton se kompania [REDAKTUAR] nuk figuron e regjistruar në regjistrin Tregtar Shqiptar dhe në Degën e Tatimeve, pra është subjekt jo rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi, çdo subjekt qoftë ky dhe jo rezident, që kryen aktivitet ekonomik në vendin tonë, duhet të paguajë tatim në burim për të ardhurat e përfituara nga zhvillimi i aktivitetit të tij ekonomik, pasi në nenin 9 të ligjit nr. 9920, datë 10.05.2008 është përcaktuar se të gjitha të ardhurat, me burim në Shqipëri, janë objekt i tatimit përfundimtar, të mbajtur në burim. PIU/MSH dhe Drejtoria Ekonomike në MSH, duhet të kishte kërkuar zbritjen e vlerës së tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga kompania dhe shuma përkatëse duhej mbajtur dhe derdhur në Degën e

Tatimeve Tiranë. Nga sa më sipër rezulton se për Buxheti e Shtetit është shkaktuar **një dëm ekonomik në shumën 1,639,692 euro.**

***Për sa më lart rekomandojmë:***

*KLSH gjetjen e mësipërme e konsideron dëm ekonomik, i ardhur nga mos mbajta e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga shërbimi i realizuar në Shqipëri nga kompania [REDAKTUAR], për implementimin e projektit e-Health, por për më tej e përcjellim për kompetencë dhe vlerësim në Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave, e cila mbas studimit ta përcjell për veprim tek Ministria e Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë të zbatojë menjëherë vlerësimin e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik në MF, për këtë çështje.*

***Menjëherë***

**C. MASA DISIPLINORE**

I. Mbështetur në nenet 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115 date 5.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Ministrit të Shëndetësisë, që të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

***a. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, neni 58 pika b, për:***

1. ***Znj [REDAKTUAR]*** në cilësinë e Drejtueses për IT dhe Infrastrukturën e projektit e-Health dhe në cilësinë e anëtares së grupit të ngritur me urdhër të Ministrit nr. 149 datë 31.03.2015, për verifikimin e pajisjeve për projektin e-Health, për arsye se:

-Të mos identifikimit të mungesës së artikullit me numër rendor 49, me product code **OPSERA-OPSV** dhe me çmim për njësi **113,200 euro**, në dërgesën e pajisjeve të përcaktuara në dokumentin e emërtuar Attachment A-Equipment of 2<sup>nd</sup> Delivery (Hardware).

-Për pranimin dhe mos marrjen e asnjë veprimi për programin OPSERA-OPSV, i cili është download (shkarkuar) nga faqja zyrtare e OPSVIEW dhe të cilin kompania AME nuk e ka blerë, ndërsa sipas listës bashkëlidhur faturës nr. 111520002 çmimi i programit është faturuar në shumën 113,200 euro. Gjithashtu ndonëse programi është free (pa pagesë) nga MSH janë paguar shpenzimet për TVSH duke e çuar vlerën e sistemit në shumën **135,840 euro, shumë e cila përbën dëm ekonomik**. Fakti që programi është siguruar pa pagesë nga shitësi, është identifikuar edhe nga korenspondenca që Drejtuesia për IT dhe Infrastrukturën e projekti e-Health, ka pas me projekt menaxherin e palës austriake, por e cila nuk është marr asnjë masë për të bërë të mundur mos pagesën për një program free (pa pagesë).

-Mos marrjes së masave për të bërë të mundur funksionimin sa më të plotë të programit e-Health, për site-t ku programi është implementuar, me qëllim shmangien dhe minimizimin e mangësive të konstatuar në implementimin dhe funksionimin e programit e-Health për site ku është funksional programi ndër të cilat janë verifikuar në terren nga grupi i auditimit Poliklinika e Specialiteteve nr. 2, Spitali Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Spitali Rajonal Elbasan, Poliklinika e Specialiteteve Elbasan, Spitali Librazhdë, Poliklinika e Specialiteteve Librazhd, Spitali dhe Poliklinika e Specialiteteve Lushnje, Spitali dhe Poliklinika e Specialiteteve Laç.

- Nga auditimi i praktikave të mbërritjes së mallit në Shqipëri konstatohet se grupi i punës për verifikimin bashkë me përfaqësuesit e kontraktorit kanë hartuar certifikatën COACS (Certifikatë e Mbërritjes të Magazinimit), certifikatë e cila dokumenton vetëm mbërritjen e mallrave në magazinë. Ky grup nuk ka bërë verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve të ardhura. Veprimet dhe mosveprimet e grupit të ngarkuar për verifikimin e pajisjeve janë në kundërshtim me pikat 42-50 të seksionit “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 1.3.1 e kontratës së blerjes.

2. Z. ■ Drejtuës për Trajnime dhe Përdorimin e Aplikacionit të programit e-Health, për arsye të:

-Mos marrjes së masave për të bërë të mundur funksionimin sa më të plotë të programit e-Health, për site-t ku programi është implementuar, me qëllim shmangien dhe minimizimin e mangësive të konstatuar në implementimin dhe funksionimin e programit e-Health për site ku është funksional programi ndër të cilat janë verifikuar në terren nga grupi i auditimit Poliklinika e Specialiteteve nr. 2, Spitali Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Spitali Rajonal Elbasan, Poliklinika e Specialiteteve Elbasan, Spitali Librazhdë, Poliklinika e Specialiteteve Librazhd, Spitali dhe Poliklinika e Specialiteteve Lushnje, Spitali dhe Poliklinika e Specialiteteve Laç.

- Mos marrjen e masave për rritjen e shkallës së hedhjes së të dhënave në sistem pasi: nga krahasimi i të dhënave të hedhura në sistem u konstatua se në regjistrat e Poliklinikës nr. 2 Tiranë për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 69.040 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 3.677 pacientë ose 5.3% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 23,470 ndërsa në sistem janë hedhur 838 pacientë ose 3.6 % e vizitave.

Në regjistrat e Spitalit Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 11.380 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem nuk janë hedhur. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 3.901 ndërsa në sistem nuk janë hedhur.

Për periudhën shkurt-mars 2016 numri i pacientëve të regjistruar në regjistër në Poliklinikë është 4.046, ndërsa numri i pacientëve të hedhur në sistem është 144 ose 4.3%.

Në regjistrat e Poliklinikës Librazhd për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 12.628 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 4.323 pacientë ose 34% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 6.027 ndërsa në sistem janë hedhur 1.557 pacientë ose 26 % e vizitave.

Në regjistrat e Spitalit Elbasan për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 15.231 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 8.795 pacientë ose 58% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 4.299 ndërsa në sistem janë hedhur 2.764 pacientë ose 64% e vizitave.

Në regjistrat e Poliklinikës Elbasan për periudhën 01.07.2015 - 31.12.2015 janë regjistruar në regjistër (manualisht) 110.924 pacientë për vizita të ndryshme ndërkohë në sistem janë hedhur vetëm 4.256 pacientë ose 3.8% e vizitave. Për periudhën 01.01.2016 - 29.02.2016 janë regjistruar në regjistra 28.226 ndërsa në sistem janë hedhur 1.618 pacientë ose 5.7% e vizitave.

Për periudhën shkurt-mars 2016 numri i pacientëve të regjistruar në regjistër është 6.774, ndërsa numri i pacientëve të hedhur në sistem është 897 ose 15.6%.

**b. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 pika c për:**

**1** [REDAKTUAR] dhe

**2** [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarëve së grupit të ngritur me urdhër të Ministrit nr. 149 datë 31.03.2015, për verifikimin e pajisjeve për projektin projekti e-Health, për arsye se:

-Të mos identifikimit të mungesës së artikullit me numër rendor 49, me product code **OPSERA-OPSV** dhe me çmim për njësi **113,200 euro**, në dërgesën e pajisjeve të përcaktuara në dokumentin e emërtuar Attachment A-Equipment of 2<sup>nd</sup> Delivery (Hardware).

-Për pranimin dhe mos marrjen e asnjë veprimi për programin OPSERA-OPSV, i cili është download (shkarkuar) nga faqja zyrtare e OPSVIEW dhe të cilin blerësi AME nuk e ka blerë, ndërsa sipas listës bashkëlidhur faturës nr. 111520002 çmimi i programit është faturuar në shumën 113,200 euro. Gjithashtu ndonëse program është free (pa pagesë) nga MSH janë paguar shpenzimet për TVSH duke e çuar vlerën e sistemit në shumën **135,840 euro, shumë e cila përbën dëm ekonomik.**

Nga auditimi i praktikave të mbërritjes së mallit në Shqipëri konstatohet se grupi i punës për verifikimin bashkë me përfaqësuesit e kontraktorit kanë hartuar certifikatën COACS (Certifikatë e Mbërritjes të Magazinimit), certifikatë e cila dokumenton vetëm mbërritjen e mallrave në magazinë. Ky grup nuk ka bërë verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve të ardhura. Veprimet dhe mosveprimet e grupit të ngarkuar për verifikimin e pajisjeve janë në kundërshtim me pikat 42-50 të seksionit “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 1.3.1 e kontratës së blerjes.

**Shënim:** Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për ish-projekt menaxheren e projektit [REDAKTUAR], ish-drejtorin e projektit z. [REDAKTUAR] për të cilën nuk rekomandojmë masa disiplinore duke i konsideruar të ezauruar, për arsye se këta persona nuk janë në marrëdhënie pune me Ministrinë e Shëndetësisë. Masat disiplinore për këta persona do të ishin; “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” ose “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**